

Vendim nr. 235, datë 08.07.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim, anëtarë, në datën 08.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (T) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TUNXH VATNIKAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4885 (393), datë 30.10.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, 134, pika 1, shkronja “i”, 142 dhe 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 2526, datë 14.02.2000. Në vitin 2008, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 21.05.2008, kërkuesi është emëruar drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9877/2008*), i cili parashikonte të drejtën e gjyqtarëve që me kërkesë të institucioneve e me pëlqimin e tyre dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*KLD*) të shërbenin deri në tre vjet në pozicione të tjera dhe në përfundim të këtij afati të ktheheshin në vendin e mëparshëm të

punës. Në vitin 2009, me vendimin nr. 54, datë 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave kërkuesi është shkarkuar nga detyra e drejtorit të përgjithshëm AKKP-së për shkelje disiplinore dhe për të është regjistruar edhe procedimi penal nr. 4908 i vitit 2008 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal. Për sa i përket çështjes penale ndaj kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarin e tij të pafajshëm, vendim që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Pas marrjes formë të prerë të vendimit të pafajësisë, kërkuesi i është drejtuar KLD-së për rikthimin në detyrën e gjyqtarit, kërkesë për të cilën nuk ka marrë përgjigje. Në këto kushte, ai i është drejtuar gjykatës me padi për detyrimin e KLD-së që të marrë në shqyrtim kërkesën për rikthimin në detyrë, si dhe detyrimin e atij organi për t’i paguar pagën e gjyqtarit nga data 21.02.2009, deri në fillimin e detyrës.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2839, datë 25.05.2015, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e KLD-së që të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit, vendim që është lënë në fuqi me vendimin nr. 121, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1057, datë 16.10.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të të paditurës, KLD-së. Për shkak se këto vendime nuk janë ekzekutuar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) me kërkesë për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për këtë shkak. Me vendimin e datës 04.07.2024, *GJEDNJ*-ja ka vendosur nxjerrjen aplikimit nga lista, për shkak të zgjidhjes së çështjes me marrëveshje, pasi shteti shqiptar ka pranuar t’i paguajë kërkuesit dëmshpërblim për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

3. Në datën 18.02.2013 kërkuesi i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGGJ*) me kërkesë për rikthimin në detyrën e gjyqtarit. Me vendimin nr. 243, datë 29.10.2019 (*vendimi nr. 243/2019*), *KLGGJ*-ja ka vendosur refuzimin e kërkesës, duke arsyetuar se ai: nuk ka paraqitur kërkesë për t’u rikthyer në funksionin e tij në përfundim të afatit 3-vjeçar të komandimit, ndaj KLD-ja nuk mund të vijonte ruajtjen e vendit të punës si gjyqtar; nuk i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar e nuk ka plotësuar dhe dorëzuar formularët përkatës për këtë qëllim; nuk ka paraqitur kërkesë për pavlefshmëri të akteve të procedimit penal dhe nuk ka qenë i pezulluar nga detyra e gjyqtarit; nuk ka kundërshtuar aktin e shkarkimit nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së; masa disiplinore e shkarkimit nga detyra përbën kriter ndalues për rekrutimin e gjyqtarit dhe është shkak për mbarimin e statusit të magjistratit. Këtë vendim kërkuesi e ka kundërshtuar në gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ, detyrimin e *KLGGJ*-së ta kthejë në funksionin e gjyqtarit, si dhe rregullimin e pasojave për pagesën e pagës nga data 21.02.2009 deri në rikthimin e tij në detyrë.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 42, datë 28.02.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se mosparaqitja në kohë e kërkesës për rikthimin në detyrë është ekuivalente me dorëheqjen. Po sipas asaj gjykate, për sa kohë nuk është provuar dhënia e autorizimit nga KLD-ja për fillimin e procedimit penal, kërkuesi nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i tij, prandaj, pavarësisht se me vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm, nuk kishte më të drejtë të kthehej në detyrën e mëparshme. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.07.2024, me arsyetimin se ai është i drejtë dhe se vendimi i KLGJ-së që ka refuzuar kërkesën për kthimin e kërkuesit në funksionin e gjyqtarit është një akt administrativ i mbështetur në prova dhe në ligj.

5. Në datën 09.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve të mësipërme. Me vendimin nr. 28, datë 30.04.2025 (*vendimi nr. 28/2025*), Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në atë gjykatë. Në vlerësimin e Gjykatës, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes së kërkuesit, duke bërë një interpretim abstrakt të ligjit, i cili nuk pajtohet me gjykimin konkret, duke mos zgjidhur mosmarrëveshjen në fjalë. Në këtë kuptim, pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë rezulton të jetë formaliste, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese të individit. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës, duke e bërë atë haptazi të paarsyeshëm.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rigjykimin e kësaj çështjeje, me vendimin nr. 00-2025-4885 (393), datë 30.10.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke vlerësuar se ai është në përputhje me ligjin dhe me parimet e gjykit të drejtë. Në përputhje me detyrat e përcaktuara nga Gjykata, në vendimin nr. 28/2025, ai kolegji ka vlerësuar se ka analizuar në mënyrë të plotë çdo çështje të theksuar prej saj, përfshirë kuptimin dhe zbatimin e neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 9877/2008, efektet e ndjekjes penale dhe të mungesës së pezullimit, sjelljen e paditësit gjatë gjithë periudhës përkatëse, mosveprimin e KLD-së, ndikimin e masës disiplinore, si dhe detyrimet që burojnë nga ligjet nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* dhe nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* për subjektet e rivlerësimit kalimtar. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ, nga analiza e plotë e provave dhe e ligjit të zbatueshëm, kërkuesi nuk ka provuar ekzistencën e statusit të gjyqtarit në kohën e paraqitjes së kërkesës për rikthim, as ndonjë shkelje të të drejtave të tij nga KLGJ-ja, dhe sjellja e

tij pasive, mosankimi i masës disiplinore, mospërmbushja e detyrimeve për *vettingun* dhe mungesa e çdo veprimi brenda afateve ligjore tregojnë se ai nuk e ka ruajtur statusin dhe nuk mund të kërkojë rikthim në sistemin gjyqësor.

7. Në datën 15.04.2026 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Ndërsa me vendimin e datës 02.07.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e heqjes dorë të një anëtarit të Kolegjit të Gjykatës dhe zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër. Kolegji i Gjykatës, në datën 03.07.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, kurse me vendimin e datës 06.07.2026 ka vendosur pranimin e heqjes dorë edhe të një gjyqtari tjetër.

II

Pretendimet e kërkuessit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës së aksesit efektiv*, pasi kërkuesi nuk ka pasur mundësi të paraqesë argumentet e tij, ndërsa gjykatat nuk e kanë thirrur asnjëherë për të parashtruar pretendimet për procesin e kundërshtuar.

8.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ nuk është shprehur për shkeljen flagrante të ligjit dhe të Kushtetutës për procedurën e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se me vendimin nr. 28/2025 Gjykata i ka dhënë mundësinë atij kolegji të konstatonte shkeljet dhe të rivendoste të drejtën e shkelur të kërkuessit, ai nuk ka vepruar, duke thelluar shkeljet kushtetuese e anashkaluar vendimin e Gjykatës, duke shkelur nenin 132, pika 1, të Kushtetutës. Kolegji Administrativ e ka arsyetuar vendimin duke e interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin dhe në kundërshtim të hapur me vendimet e mëparshme të Gjykatës si dhe ka keqinterpretuar njëkohësisht edhe rrethanat e faktit.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. *Për legjitimitimin e kërkuessit*

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose

vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Po kështu, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Mbledhja e Gjyqtarëve do të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të legjitimitimit *ratione materiae* të kërkuësit.

11. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren, fillimisht, se kërkuuesi ka pretenduar, mes të tjerash, cenimin e *së drejtës së aksesit efektiv*, pasi nuk ka pasur mundësi të paraqesë argumentet e tij, ndërsa gjykatat nuk e kanë thirrur asnjëherë për të parashtruar pretendimet për procesin e kundërshtuar. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në procesin administrativ dhe në atë gjyqësor është ngritur nga kërkuuesi edhe në kërkesën e mëparshme drejtuar Gjykatës, për të cilën ajo ka vlerësuar se ai nuk është ngritur më parë në formë dhe në përmbajtje, as në kërkesëpadi, as në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por është parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, për këtë pretendim, Gjykata ka vlerësuar se kërkuuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion (*shih paragrafin 17 të vendimit nr. 28, datë 30.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, për sa kohë që për këtë pretendim është konsideruar se kërkuuesi nuk plotëson kriteret paraprake të legjitimitimit të tij, ai nuk mund të merret më në shqyrtim.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuuesi ka pretenduar se i është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit, pasi Kolegji Administrativ nuk është shprehur për shkeljen flagrante të ligjit dhe Kushtetutës në lidhje me procedurën e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se me vendimin nr. 28/2025 Gjykata i dha mundësinë atij kolegji të konstatonte shkeljet dhe të rivendoste të drejtën e shkelur të kërkuësit, ai nuk veproi, duke thelluar shkeljet kushtetuese duke anashkaluar vendimin e Gjykatës, dhe në shkelje të nenit 132, pika 1, të Kushtetutës. Kolegji Administrativ e ka arsyetuar vendimin duke e interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin dhe në kundërshtim të hapur me vendimet e mëparshme të Gjykatës, duke

keqinterpretuar njëkohësisht edhe rrethanat e faktit. Për nga natyra dhe thelbi i tyre, por edhe nga fakti se çështja është shqyrtuar edhe më parë nga Gjykata, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se këto pretendime do të vlerësohen në vijim në drejtim të respektimit nga Gjykata e Lartë të standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

13. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht për forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (shih vendimet nr. 66, datë 06.12.2023; nr. 49, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar edhe domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Në tërësinë e tij vendimi duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Lidhur me këtë standard, Gjykata ka analizuar edhe të drejtën e aksesit, duke pohuar se kjo e drejtë u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet t'i dëgjojë dhe t'u japë përgjigje pretendimeve të tyre (shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 5, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi, gjatë kohës që ushtronte funksionin e gjyqtarit të zakonshëm, është lejuar me vendim të KLD-së të ushtrojë detyrën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për një periudhë 3-vjeçare në përputhje me parashikimin e nenit 28 të ligjit nr. 9877/2008. Gjatë ushtrimit të asaj detyre, ai është shkarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe, në vijim, është akuzuar dhe gjykuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, ku në përfundim të gjykimit është deklaruar i pafajshëm nga gjykatat. Pas marrjes formë të prerë të vendimit të pafajësisë, kërkuesi ka kërkuar nga KLD-ja rikthimin në detyrë. Për shkak se nuk ka marrë përgjigje nga ai organ, kërkuesi ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor, përmes të cilit gjykatat kanë detyruar KLD-në që të shqyrtojë kërkesën e tij, megjithatë ajo kërkesë nuk u shqyrtua asnjëherë nga KLD-ja (organi kompetent në atë kohë). Pas ristrukturimit të disa organeve të sistemit të drejtësisë në vitin 2016, kërkuesi i është

drejtuar KLGJ-së me kërkesë për rikthimin në funksionin e gjyqtarit, kërkesë e cila është refuzuar. Ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila e ka rrëzuar padinë, me arsyetimin se kërkesa për rikthimin në funksionin e gjyqtarit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor 3-vjeçar sipas ligjit nr. 9877/2008, dhe se heshtja e kërkuarit përgjatë kësaj periudhe përbën, në thelb, heqje dorë nga e drejta sipas pikës “a” të nenit 20 të ligjit nr. 9877/2008. Sipas asaj gjykate, për sa kohë nuk është provuar dhënia e autorizimit nga KLD-ja për fillimin e procedimit penal, kërkuar nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni, prandaj, pavarësisht se me vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm, nuk kishte më të drejtë të kthehej në detyrën e mëparshme (*shih faqet 27-29 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

16. Vendimi i gjykatës së apelit është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se kërkuar ka humbur statusin e gjyqtarit, pasi nuk ka paraqitur kërkesë për rikthim as kur është shkarkuar nga detyra e drejtorit të AKKP-së, as në përfundim të afatit ligjor 3-vjeçar të komandimit, i cili ka përfunduar në vitin 2011. Sipas asaj gjykate, ai nuk ka paraqitur as kërkesë për t’iu nënshtruar vullnetarisht procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, ndonëse mendonte se ishte në kushtet kur ai duhej të rikthehej në detyrë. Për më tepër, sipas asaj gjykate, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra si drejtor i përgjithshëm i AKKP-së përbënte, sipas nenit 28, shkronja “dh”, të ligjit nr. 96/2016, ndalim për KLGJ-në që të rikthente kërkuarin në detyrën e gjyqtarit (*shih paragrafët 20,21 dhe 23 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

17. Mbi ankimin kushtetutës të kërkuarit, Gjykata, me vendimin nr. 28/2025, ka shfuqizuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim po në atë gjykatë. Gjykata i analizoi në themel pretendimet e kërkuarit, në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë. Ajo ka vlerësuar se thelbi i çështjes ishte mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë zbatuar kuadrin ligjor në fuqi që rregullon rastet e kthimit në funksionin e gjyqtarit, ndaj u ndal në verifikimin nëse interpretimi i ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete ishte ose jo haptazi i paarsyeshëm. Gjykata, vërejti se argumentet kryesore të gjykatave për rrëzimin e padisë ishin: i) kërkuar nuk ka paraqitur kërkesë në përfundim të afatit ligjor 3-vjeçar dhe nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i gjyqtarit; ii) ndaj tij ka një masë disiplinore të shkarkimit nga detyra; iii) ai nuk i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar.

18. Për sa i përket *shkakut të parë*, Gjykata vlerësoi se gjykatat nuk kanë analizuar në kuptim të parashikimeve të nenit 29 të ligjit nr. 9877/2008 dhe të pretendimeve të kërkuarit: i) nëse paraqitja e kërkesës për kthimin në detyrë do të kishte perspektivë suksesi dhe do të rezultonte një mjet efektiv për kthimin në detyrë brenda kohës së komandimit; ii) nëse kishte pengesë për të paraqitur kërkesë për rikthimin në detyrë, ndërkohë kur KLD-ja as nuk e kishte pezulluar, as nuk e rikthente në detyrë; iii) faktet përcaktuese të sjelljes së kërkuarit në drejtim të shprehjes së

vullnetit për vijimin ose përfundimin e statusit të tij. Sipas Gjykatës, gjykatat nuk kanë analizuar dhe pasqyruar se kërkuksi ka shfaqur interes dhe ka përdorur çdo mjet që në dukje mund të rezultonte i suksesshëm për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe as sjelljen e KLD-së, që nuk e ka marrë në shqyrtim kërkesën e tij për një periudhë disavjeçare. Për sa i përket *shkakut të dytë*, Gjykata ka konstatuar se masa e shkarkimit nga detyra është marrë gjatë ushtrimit të një funksioni administrativ dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar nëse një masë e tillë parashikohej edhe në nenin 32, pika 2, të ligjit nr. 9877/2008. Kurse për sa i përket *shkakut të tretë*, Gjykata ka vlerësuar se gjykatat nuk kanë analizuar dhe interpretuar mënyrën e zbatimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për rivlerësimin kalimtar në momentin e hyrjes në fuqi, përfshirë detyrimin e gjyqtarëve në detyrë ose të ish-gjyqtarëve për të dorëzuar formularët e vetëdeklarimit, në kushtet kur kërkuksi nuk kishte një vendim të organit administrativ për statusin e tij dhe as efektet që do të kishte një kërkesë drejtuar institucioneve të rivlerësimit në mungesë të vendimit të organit kompetent për (mos)pasjen e statusit të gjyqtarit.

19. Mbi këto argumente, Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë nuk kishte marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes së kërkuksit, duke bërë një interpretim abstrakt të ligjit, i cili nuk pajtohej me gjykimin konkret, duke mos zgjidhur mosmarrëveshjen në fjalë. Në këtë kuptim, në vlerësimin e Gjykatës, pjesa arsyetuese e vendimit të Gjykatës së Lartë ishte formaliste, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese të individit, dhe vendimit i mungonte analiza nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës, duke e bërë atë haptazi të paarsyeshëm.

20. Në rigjykimin e kësaj çështjeje, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në përfundim, ai ka vlerësuar se Gjykata ka përcaktuar detyra konkrete për rishqyrtimin e çështjes që kanë të bëjnë me statusin e kërkuksit si gjyqtar, efektet e ndjekjes penale ndaj tij, mosveprimin e KLD-së, masën disiplinore të shkarkimit dhe raportin e tij me procesin e rivlerësimit kalimtar, të cilat kërkojnë interpretimin e plotë të dispozitave ligjore të zbatueshme të kohës në dritën e rrethanave konkrete dhe të sjelljes së palëve në proces.

21. Për sa i përket *shkakut të parë*, Kolegji Administrativ është ndalur në analizën e përmbajtjes së neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 9877/2008, duke vlerësuar se leja për shërbim në institucione të tjera ka karakter të përkohshëm dhe jepet për një periudhë deri në tre vjet, ndërkohë që neni 28 nuk parashikon zgjatje automatike të efektit të saj. Në këtë kuptim, ruajtja e statusit pas përfundimit të afatit nuk mund të ndodhë pa ndonjë veprim të gjyqtarit për rikthim ose për zgjatje të lejes dhe mospasja e një kërkesë të tillë përbën pasivitet që sjell mbarimin e efektit të vendimit të KLD-së në mënyrë të heshtur. Në vlerësim të rrethanave të çështjes konkrete, sipas Kolegjit

Administrativ, afati maksimal i lejes përfundonte më 21.05.2011 dhe kërkuesi, pavarësisht se e ka përfunduar ushtrimin e funksionit administrativ përpara mbarimit të këtij afati, as në momentin e shkarkimit nga Këshilli i Ministrave, as në momentin e përfundimit *de jure* të afatit ligjor trevjeçar nuk i është drejtuar KLD-së për rikthimin në detyrë ose për zgjatjen e periudhës së emërimit, por e ka paraqitur kërkesën pas më shumë se një viti e gjysmë pas përfundimit të afatit ligjor. Në këto kushte, në vlerësimin e atij kolegji, në mungesë të kësaj kërkeje, KLD-ja objektivisht nuk ka pasur mundësi të identifikojë vullnetin e gjyqtarit për t'u rikthyer në detyrë.

22. *Për sa i përket shkakut të dytë*, sipas Kolegjit Administrativ, nuk rezulton të jetë dhënë autorizim nga KLD-ja për fillimin e procedimit penal dhe nuk ekziston vendim për pezullimin nga detyra sipas nenit 29 të ligjit nr. 9877/2008, çka do të thotë se kërkuesi nuk ka qenë formalisht i pezulluar nga funksioni i gjyqtarit, për rrjedhojë kishte të drejtën ligjore të kërkonte rikthim në detyrë brenda afatit të përcaktuar. Sipas atij kolegji, sjellja e kërkuesit gjatë periudhës 2009–2013 tregon mungesë interesi për të ruajtur statusin si gjyqtar, pasivitet i gjatë që tregon heqjen dorë në heshtje nga ushtrimi i funksionit. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se mosveprimi i gjatë i KLD-së, edhe pse i pajustificuar, nuk krijon të drejtë për rikthim automatik në detyrë. Kurse në lidhje me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra nga Këshilli i Ministrave, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se ajo nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore dhe ka mbetur në fuqi, duke prodhuar efekte të plota juridike që, sipas nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 9877/2008, përbën shkelje që diskrediton rëndë figurën e gjyqtarit, pra përbën pengesë ligjore për rikthim në sistemin gjyqësor. Pavarësisht mungesës së parashikimit ligjor, në vlerësimin e atij kolegji nuk përjashtohet ndikimi i kësaj mase disiplinore në vijimin e ushtrimit të mëtejshëm të detyrës së gjyqtarit.

23. *Për sa i përket shkakut të tretë*, Kolegji Administrativ ka vlerësuar, bazuar në parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, se detyrimi për t'u vetëdeklaruar nuk lidhet me ndonjë vullnet të KLD-së ose të organeve të rivlerësimit, por lindte vetvetiu për çdo subjekt që pretendonte ose kishte ushtruar statusin e gjyqtarit, duke e gjetur të pabazuar pretendimin e kërkuesit se “priste njoftim” nga organet përkatëse për të dorëzuar dokumentet. Mosparaqitja e deklaratave të pasurisë dhe të figurës është shprehje e mungesës së vullnetit për të qenë pjesë e sistemit gjyqësor, duke u përkthyer në heqjen dorë nga ky status. Bazuar dhe në praktikën e organeve të rivlerësimit kalimtar, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se mosdorëzimi i deklaratave çon automatikisht në shkarkimin nga detyra ose pushimin e procesit me konstatimin e mbarimit të statusit të magjistratit.

24. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk ka provuar ekzistencën e statusit të gjyqtarit në kohën e paraqitjes së kërkesës për rikthim, as ndonjë shkelje të të drejtave të tij nga KLGJ-ja, dhe se sjellja pasive, mosankimi i masës disiplinore,

mospërbushja e detyrimeve për *vettingun* dhe mungesa e çdo veprimi brenda afateve ligjore tregojnë se ai nuk e ka ruajtur statusin dhe nuk mund të kërkojë rikthim në sistemin gjyqësor.

25. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në këto standarde, dhe referuar arsyetimit të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë konstaton se ai, në përputhje me arsyetimin e vendimit nr. 28/2025 të Gjykatës, në interpretim të dispozitave ligjore të zbatueshme ndaj rrethanave të çështjes konkrete, që kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e tij, dhe me veprimet e organeve kompetente, u ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuarit të ngritura në kërkesëpadi. Vendimi i Kolegjit Administrativ pasqyron tërësinë e fakteve/ngjarjeve, ashtu siç janë administruar në gjykim, identifikon ligjin e zbatueshëm, si dhe mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të tij. Mënyra e arsyetimit të çështjes së kërkuarit është në linjë me orientimin e Gjykatës dhe përfundimet e arritura prej Kolegjit Administrativ nuk rezultojnë që të jenë alogjike, të kenë kundërtënie ose të mos respektojnë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese, ndërkohë që ai vendim përmban arsyetim të plotë dhe të detajuar të pretendimeve të parashtruara nga kërkuari. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj, ka marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes së kërkuarit, duke bërë një interpretim konkret të ligjit të zbatueshëm dhe duke zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen në fjalë.

27. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se Gjykata e Lartë rezulton se i ka përmbushur detyrat e përcaktuara nga vendimi nr. 28/2025 i Gjykatës, ndaj pretendimet e kërkuarit janë haptazi të pabazuara.

28. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.